



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

KODI I ETIKËS PËR EKSPERTËT E ANGAZHUAR NGA ASCAL

Qershor 2026

Përmbajtja:

Neni 1	3
Qëllimi	3
Neni 2	3
Fusha e zbatimit.....	3
Neni 3	3
Parimet themelore.....	3
Neni 4	4
Pavarësia dhe shmangia e konfliktit të interesit	4
Neni 5	5
Objektiviteti në vlerësim, analizë dhe këshillim	5
Neni 6	5
Konfidencialiteti	5
Neni 8	6
Komunikimi institucional.....	6
Neni 9	6
Bashkëpunimi me grupin e punës dhe ASCAL.....	6
Neni 11	7
Ndalimi i përfitimeve të padrejta.....	7
Neni 12	7
Përdorimi i informacionit dhe pronësisë intelektuale.....	7
Neni 13	7
Respektimi i diversitetit dhe mosdiskriminimi.....	7
Neni 14	7
Përgjegjësia ndaj ASCAL.....	7
Neni 15	8
Shkeljet e Kodit të Etikës	8
Neni 16	8
Masat në rast shkeljeje.....	8
Neni 17	8
Ndjekja dhe monitorimi.....	8
Neni 18	9
Hyrja në fuqi.....	9

Neni 1

Qëllimi

Ky Kod Etike përcakton parimet, standardet dhe rregullat e sjelljes profesionale që duhet të respektojnë ekspertët e angazhuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), gjatë ushtrimit të detyrave të tyre në proceset e vlerësimit të jashtëm, akreditimit institucional dhe/ose akreditimit të programeve të studimit, si dhe në çdo proces tjetër profesional, teknik, këshillimor, analitik, monitorues, trajnues apo mbështetës që realizohet në kuadër të veprimtarisë së ASCAL.

Kodi synon të garantojë integritetin, paanshmërinë, objektivitetin, transparencën dhe besueshmërinë e veprimtarisë së ekspertëve të angazhuar nga ASCAL, të mbrojë cilësinë dhe seriozitetin e proceseve institucionale të Agjencisë, si dhe të forcojë besimin e institucioneve të arsimit të lartë, studentëve, publikut dhe aktorëve të tjerë në sistemin e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky Kod zbatohet për të gjithë ekspertët vendas dhe të huaj të angazhuar nga ASCAL në cilësinë e anëtarëve të grupeve të vlerësimit të jashtëm, ekspertëve të angazhuar për kryerjen e analizave, studimeve, monitorimeve, trajnimeve, asistencës teknike, konsulencës profesionale, apo çdo personi tjetër të angazhuar nga ASCAL në kuadër të veprimtarisë së saj institucionale. Dispozitat e këtij Kodi janë të zbatueshme për secilin ekspert në masën që lidhen me natyrën, fushën dhe detyrat e angazhimit të tij pranë ASCAL.

Dispozitat e këtij Kodi zbatohen gjatë gjithë periudhës së angazhimit të ekspertit, përfshirë fazën përgatitore, shqyrtimin e dokumentacionit, komunikimet me ASCAL-in dhe palët e treta, pjesëmarrjen në takime, vizita, intervista, trajnime, monitorime ose aktivitete të tjera, hartimin e raporteve, analizave, rekomandimeve, materialeve metodologjike apo produkteve të tjera profesionale, si dhe çdo veprim tjetër të lidhur me detyrën për të cilën eksperti është angazhuar, për aq sa këto veprimtari janë pjesë e angazhimit të tij konkret.

Neni 3

Parimet themelore

Ekspertët e angazhuar nga ASCAL udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:

Integriteti profesional, duke vepruar me ndershmëri, përgjegjësi dhe seriozitet në çdo fazë të angazhimit.

Paanshmëria dhe objektiviteti, duke shmangur çdo ndikim personal, institucional, politik, ekonomik apo profesional që mund të çënojë gjykimin e pavarur.

Pavarësia, duke ushtruar detyrën pa presion, ndërhyrje apo ndikim nga palë të treta.

Konfidencialiteti, duke ruajtur të dhënat, dokumentet, informacionet, diskutimet dhe materialet e marra ose të prodhuara gjatë angazhimit.

Transparenca dhe përgjegjshmëria, duke vepruar në përputhje me procedurat, metodologjitë dhe kërkesat e ASCAL, si dhe duke dokumentuar në mënyrë të qartë, të argumentuar dhe të verifikueshme çdo vlerësim, analizë, rekomandim apo produkt profesional.

Respekti institucional dhe profesional, duke komunikuar në mënyrë korrekte, etike dhe bashkëpunuese me ASCAL-in, institucionet e arsimit të lartë, studentët, stafin akademik dhe administrativ, ekspertët e tjerë dhe çdo palë të përfshirë në proces.

Neni 4

Pavarësia dhe shmangia e konfliktit të interesit

Eksperti ka detyrimin të deklarojë çdo rrethanë që mund të përbëjë konflikt interesi real, potencial ose të perceptuar në lidhje me institucionin, programin, projektin, aktivitetin, dokumentin, procesin apo çështjen për të cilën angazhohet.

Eksperti është i detyruar të njoftojë menjëherë ASCAL-in për çdo konflikt interesi përpara pranimit të angazhimit ose sapo rrethana të tilla bëhen të njohura gjatë procesit. ASCAL vlerëson rastin dhe vendos për vijimin, kufizimin ose ndërprerjen e angazhimit të ekspertit.

Për ekspertët në cilësinë e anëtarëve të grupeve të vlerësimit të jashtëm konsiderohen raste të konfliktit të interesit rastet në vijim:

- Eksperti është punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme gjatë 5 viteve të fundit në IAL;
- Eksperti ka patur konflikte gjyqësore gjatë 5 viteve të fundit me IAL;
- Eksperti ka qenë vlerësues i jashtëm i provimeve gjatë 3 viteve të fundit në IAL;
- Eksperti ka aplikuar për një pozicion pune gjatë 3 viteve të fundit në IAL;
- Eksperti është anëtar i ndonjë organi në IAL;
- Eksperti ka lidhje familjare dhe/ose martesore me persona që punojnë apo studiojnë në IAL;
- Eksperti ka qenë konsulent për IAL-në gjatë 3 viteve të fundit;
- IAL/programi që vlerësohet është konkurrent i drejtpërdrejtë i IAL-së ku është punësuar eksperti;
- Eksperti është shpërblyer për ndonjë angazhim tjetër profesional gjatë 3 viteve të fundit nga IAL (përjashtuar komisionet e mbrojtjes së doktoratës);

- Eksperti ose të afërm të tij janë ortakë të entitetit ligjor të IAL-së;
- Eksperti ushtron funksionet e mëposhtme: Rektor, Dekan, Koordinator Institucional.

Neni 5

Objektiviteti në vlerësim, analizë dhe këshillim

Eksperti duhet të bazojë vlerësimin, analizën, rekomandimin, opinionin profesional apo produktin e tij vetëm në evidenca të dokumentuara, të verifikueshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me standardet, kriteret, objektivat, termat e referencës ose detyrën për të cilën është angazhuar.

Çdo konkluzion, rekomandim apo gjykim profesional duhet të jetë i argumentuar, i balancuar dhe i mbështetur në evidenca konkrete. Eksperti nuk duhet të mbështetet në perceptime personale, paragjykime, informacione të pakonfirmuara apo qëndrime subjektive.

Eksperti duhet të shmangë çdo formulim fyes, paragjykues, të përgjithshëm apo të pambështetur në evidencë.

Neni 6

Konfidencialiteti

Eksperti ka detyrimin të ruajë konfidencialitetin e çdo informacioni, dokumenti, të dhëne, materiali apo komunikimi të marrë ose të prodhuar gjatë angazhimit me ASCAL.

Eksperti nuk duhet të publikojë, shpërndajë, përdorë apo diskutojë informacionet e marra gjatë procesit për qëllime personale, akademike, profesionale, mediatike apo komerciale, apo për çdo qëllim tjetër jashtë objektit të angazhimit, pa autorizimin paraprak të ASCAL.

Ky detyrim mbetet në fuqi edhe pas përfundimit të angazhimit të ekspertit.

Neni 7

Sjellja profesionale

Gjatë ushtrimit të detyrave, përfshirë vizitat në institucione, takimet, intervistat, trajnimet, aktivitetet publike apo komunikimet zyrtare, eksperti duhet të sillet me profesionalizëm, korrektësi, maturi dhe respekt ndaj të gjithë pjesëmarrësve në proces.

Eksperti duhet të shmangë çdo sjellje që mund të perceptohet si presion, paragjykim, favorizim, konfliktualitet, mungesë respekti apo cënim i dinjitetit të personave dhe institucioneve të përfshira.

Neni 8

Komunikimi institucional

Komunikimi zyrtar me institucionet, subjektet apo palët e përfshira realizohet sipas procedurave dhe mënyrave të përcaktuara nga ASCAL. Eksperti nuk duhet të zhvillojë komunikime të pavarura, jozyrtare apo të paautorizuara për çështje që lidhen me procesin ose detyrën për të cilën është angazhuar.

Çdo kërkesë për informacion shtesë, sqarim, dokumentacion apo ndërveprim me palë të treta duhet të bëhet nëpërmjet ASCAL-it ose në përputhje me udhëzimet e dhëna nga ASCAL.

Neni 9

Bashkëpunimi me grupin e punës dhe ASCAL

Eksperti duhet të bashkëpunojë në mënyrë konstruktive me anëtarët e tjerë të grupit të vlerësimit, grupit të punës, ekipit teknik apo strukturës përgjegjëse të ASCAL, duke respektuar ndarjen e detyrave, afatet dhe përgjegjësitë e përcaktuara.

Diskutimet brenda grupit duhet të zhvillohen me respekt profesional, mbi bazën e argumenteve dhe evidencave. Eksperti duhet të kontribuojë në hartimin e një produkti të qartë, të përbashkët dhe në përputhje me metodologjinë, formatin ose termat e referencës të miratuara nga ASCAL.

Neni 10

Raportimi dhe produktet profesionale

Eksperti ka përgjegjësi të kontribuojë në hartimin e raporteve, analizave, rekomandimeve, materialeve metodologjike, trajnimeve apo produkteve të tjera profesionale të sakta, të plota, të argumentuara dhe të dobishme për përmirësimin e cilësisë dhe përmbushjen e objektivave të ASCAL.

Raportet dhe produktet profesionale duhet të reflektojnë në mënyrë objektive gjetjet, pikat e forta, praktikat e mira, dobësitë, mangësitë, rekomandimet dhe konkluzionet përkatëse. Gjuha e përdorur duhet të jetë profesionale, neutrale, e qartë dhe e mbështetur në evidenca.

Eksperti nuk duhet të përfshijë në raport apo në produktet e tij profesionale opinione personale të pambështetura, informacione të pavërtetuara apo vlerësime që nuk lidhen me objektin e angazhimit.

Neni 11

Ndalimi i përfitimeve të padrejta

Eksperti nuk duhet të kërkojë, pranojë apo marrë asnjë përfitim financiar, material, profesional apo personal nga institucionet, subjektet ose palët e përfshira në procesin për të cilin është angazhuar nga ASCAL.

Eksperti nuk duhet të përdorë angazhimin me ASCAL për të krijuar avantazhe personale, për të siguruar marrëdhënie pune, konsulence, bashkëpunimi akademik, përfitime financiare apo përfitime të tjera të drejtpërdrejta ose të tërthorta.

Neni 12

Përdorimi i informacionit dhe pronësisë intelektuale

Dokumentet, raportet, të dhënat, analizat, materialet dhe çdo informacion i vënë në dispozicion ose i prodhuar gjatë angazhimit përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara nga ASCAL.

Eksperti nuk duhet të kopjojë, riprodhojë, shpërndajë apo përdorë këto materiale për qëllime të tjera pa miratimin përkatës të ASCAL.

Në hartimin e raporteve, analizave, materialeve metodologjike, prezantimeve apo produkteve të tjera, eksperti duhet të respektojë rregullat e integritetit akademik dhe profesional dhe të shmangë çdo formë plagjiature, kopjimi të paautorizuar apo paraqitjeje të pasaktë të burimeve.

Neni 13

Respektimi i diversitetit dhe mosdiskriminimi

Eksperti duhet të respektojë parimin e barazisë, diversitetit dhe mosdiskriminimit në çdo ndërveprim gjatë angazhimit me ASCAL.

Eksperti nuk duhet të shfaqë sjellje, komente apo qëndrime diskriminuese mbi bazën e gjinisë, moshës, kombësisë, gjuhës, besimit, aftësisë së kufizuar, orientimit personal, përkatësisë sociale, statusit akademik apo çdo karakteristike tjetër personale ose institucionale.

Neni 14

Përgjegjësia ndaj ASCAL

Eksperti duhet të respektojë aktet ligjore, nënligjore, rregulloret, udhëzimet, metodologjitë, detyrat dhe afatet e përcaktuara nga ASCAL.

Eksperti duhet të informojë ASCAL-in për çdo rrethanë që mund të ndikojë në cilësinë, objektivitetin, paanshmërinë ose përfundimin në kohë të angazhimit.

Neni 15

Shkeljet e Kodit të Etikës

Shkelje të këtij Kodi konsiderohen, ndër të tjera:

- mosdeklarimi, deklarimi i pasaktë ose fshehja e konfliktit të interesit;
- shkelja e detyrimit të konfidencialitetit;
- publikimi, shpërndarja ose përdorimi i paautorizuar i dokumenteve, të dhënave apo informacioneve të marra gjatë angazhimit;
- pranimi ose kërkimi i dhuratave, favoreve apo përfitimeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga palët e përfshira në proces;
- komunikimi i paautorizuar me institucionet e arsimit të lartë, subjektet e vlerësuara ose palë të treta për çështje që lidhen me procesin;
- vlerësimi, analiza, rekomandimi ose gjykimi profesional i njëanshëm, i pambështetur në evidenca ose i ndikuar nga interesa personale;
- përdorimi i informacionit ose i pozicionit të ekspertit për përfitime personale, profesionale ose financiare;
- mosrespektimi i procedurave, metodologjive, udhëzimeve, termave të referencës ose detyrave të përcaktuara nga ASCAL;
- mosrespektimi i afateve të përcaktuara pa arsye të justifikuara;
- dorëzimi i produkteve profesionale me cilësi të pamjaftueshme, me mangësi të përsëritura ose të pambështetura në evidenca;
- çdo formë plagjiature, manipulimi ose paraqitjeje të pasaktë të informacionit;
- sjellja joprofesionale, fyese, diskriminuese ose e papërshtatshme gjatë vizitave, takimeve, trajnimeve, monitorimeve, aktiviteteve ose komunikimeve zyrtare;
- mosbashkëpunimi me ASCAL ose me anëtarët e tjerë të grupit të punës në përmbushjen e detyrave të ngarkuara;
- çdo veprim ose mosveprim që çënon integritetin, besueshmërinë ose reputacionin e ASCAL dhe proceseve të sigurimit të cilësisë.

Neni 16

Masat në rast shkeljeje

Në rast të konstatimit të shkeljeve të dispozitave të këtij Kodi, ASCAL ka të drejtë të ndërpresë kontratën e angazhimit të ekspertit, në përputhje me kushtet e saj dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 17

Ndjekja dhe monitorimi

Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të këtij Kodi kryhet nga Këshilltari i Etikës në ASCAL, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për administrimin e angazhimit të ekspertit.

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr.Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

Tel: +355(0)2243423/2266203;

web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

Faqe 8 nga 9

Rastet e dyshuara të shkeljes shqyrtohen nga Këshilltari i Etikës dhe i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm për marrjen e masave përkatëse, sipas nenit 16 të këtij Kodi.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky Kod Etike hyn në fuqi pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i ASCAL dhe zbatohet për të gjitha proceset e vlerësimit të jashtëm dhe për çdo angazhim tjetër ekspertize të zhvilluar nga ASCAL.

Kodi i Etikës publikohet në faqen zyrtare të internetit të ASCAL menjëherë pas hyrjes në fuqi.